



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01- Nr - 020/09 - 98292 dt. 05.11. 2020

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 19 të Rregullores Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e komisionit për inventarizimin e Pasurive Jo Financiare në sektorin e Administratës së Përgjithshme


I. Me këtë Vendim emërohen anëtarët e komisionit për inventarizimin e Pasurive Jo Financiare në këtë përbërje:

1. Valmir Bajraktari (Kryetar),
2. Arberije Gllareva (Anëtarë),
3. Albulena Elshani-Morina(Anëtarë),

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit për inventarizimin e Pasurive Jo Financiare janë si në vijim:

- Inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore;
- Verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare;
- Krahasoni i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare;
- Identifikimi i pasurisë që nuk kanë vlerë të bartur;
- Identifikimi i pasurisë të dëmtuar dhe jashtë përdorimit.

- III.** Komisioni fillon punën me rastin e pranimit të këtij Vendimi.
- IV.** Komisioni duhet të raportoj para datës 08.01.2021. Raporti duhet të përmbaj gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara. Raporti përfundimtar i nënshkruar duhet t'i dorëzohet ZKA-së, ZKF-së dhe Drejtorit për Buxhet dhe Financa.
- V.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi Nr.01-020/04-48242, i datës 05.11.2020.
- VI.** Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

 Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Personelit;
- Anëtareve të Komisionit;
- Z. Kushtrim Bajraktari;
- Znj. Fluida Nika;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.